



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2021

VENDIM

Nr. 351, datë 09.09.2021

PËR

KUALIFIKIMIN E KANDIDATIT Z. {...}

**DHE VIJIMIN E PROCEDURËS SË NGRITJES NË DETYRË NË
GJYKATËN E POSAÇME TË SHKALLËS SË PARË PËR KORRUPSIONIN
DHE KRIMIN E ORGANIZUAR, PËR POZICIONIN E LIRË, TË SHPALLUR ME
VENDIMIN NR. 223, DATË 02.07.2020, TË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në pikën 4, të nenit 135, pikën 1, të nenit 147 dhe shkronjën “ë”, pika 1, të nenit 147/a, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në shkronjën “a”, pika 2, të nenit 61, në shkronjën “ë”, të nenit 86 dhe në shkronjën “a”, pika 1, të nenit 97, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, në nenin 8, në shkronjën “a”, pika 2, të nenit 47, në pikat 7 dhe 8, të nenit 48, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe në shkronjën “d”, pika 12, Seksioni Ç, Kreu VI dhe në Seksionin A, Kreu X, të Vendimit e tij nr. 75, datë 23.05.2019 “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kritereve ligjore për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë, për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve dhe për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë”, pasi shqyrtoi materialet e çështjes dhe relacionin e përgatitur nga relatori, z. Ilir Toska,

VENDOSI:

1. Kualifikimin e kandidatit z. {...} dhe vijimin e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionin e lirë, të shpallur me vendimin nr. 223, datë 02.07.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.
2. Vendimi nr. 295, datë 10.09.2020, i Këshillit të Lartë Gjyqësor është pjesë përbërëse e këtij vendimi.

3. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet kandidatit z. {...} sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.

Ky vendim hyn në fuqi në datën e publikimit në faqjen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR